



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-20843

Dt. 29.09.2020

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM (për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Drejtoria e Arsimit - Komuna e Gjakovës.		
Adresa:	Kuvendi Komunal Gjakovë		
Telefoni:	045 103 820	Emaili:	

Emri i Projektit:	Objekti i kategorisë së parë me destinim –aneksi i kopshtit “Ganimete Terbeshi” me etazhitet P+0.		
Emri i Projektuesit:	SH.P.K “ENGGROUP” - Prishtinë.		
Adresa:	Rruga “Vëllezërit Gërvalla” pn.		
Telefoni:	044 270 746	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga “Anton Qeta” pn.		
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë – J-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 5109-20, 5120-18, 5121-1 dhe 5121-3	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒

Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i Objektit të kategorisë së parë me destinim – ndërtimi i aneksit për rritjen e kapaciteteve të kopshtit “Ganimete Terbeshi” me etazhitet P+0 sipas lokacionit dhe projektit të prezantuar.

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Drejtoria e Arsimit - Komuna e Gjakovës**, i lejohet ndërtimi i Objektit të kategorisë së parë me destinim – aneksit të kopshtit “Ganimete Terbeshi” me etazhitet P+0 sipas lokacionit dhe projektit të prezantuar.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajmë regjistrë të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditorë të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.



A r s y e t i m

Aplikuesi: **Drejtoria e Arsimit - Komuna e Gjakovës**, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-20843 të datës 18.09.2020, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë me destinim **“objekt ndërtimi i aneksit të kopshtit “Ganimete Terbeshi” me etazhitet P+0 sipas lokacionit dhe projektit të prezantuar, në pronësi P.SH. KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Planin e Situacionit në përpjesë 1:1000 të datës 18.08.2020, të vërtetuar nga DUMM - Gjakovë.
- Kopjen e planit të datës 03.08.2020 (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës zyrt/20, të datës 03.08.2020, në pronësi të P.SH. KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Certifikata nga Drejtoria për Punë Inspektuese – Inspektorati Sanitar me Nr. 14-530/01-18768 të datës 31.08.2020..
- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent për mbrojtje nga zjarri me nr.302/20 të datës 23.09.2020..
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 4/586, të datës 27.08.2020.
- Pëlqimin nga K.R.U. “Gjakova” Sh.A. Gjakovë, nr. 1421 të datës 24.08.2020.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, me nr. 14 të datës. 21.08.2020.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga SH.P.K “ENGGROUP” - Prishtinë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nën paragrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:1000 të datës 18.08.2020 të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.



Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastrë Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakove Jashte Qytet

Poseduesi: 1/1 P.SH. Kuvendi Komunes
Gjakove



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
5120-1			Kullose(2)		0	36	40	
5109-20			Are(2)		0	03	20	
5120-18			Kullose(2)		0	05	20	
5121-1			Are(2)		0	06	00	
5121-3			Are(2)		0	08	31	
Gjithsejtë					0	59	11	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:

Gjakovë, 03.08.2020

SH 1:1000

